



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primjena/Prodato Received/Delivered	22-03-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAPUSHEK	2882/2023		112



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.375/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbi in Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.375/2023 të datës 20.02.2023 të parashtruar nga ankuesja nga Kamenica, në çështjen juridike "Vlerësim i rezultateve në punë", bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.03.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.375/2023 të datës 20.02.2023, të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja më datë 20.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1885/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, me pretendimet së vlerësimi në punë është përcjell më shkelje esenciale të dispozitave dhe zbatim të gabuar i dispozitave materiale.

Ndërsa me datë 20.03.2023, ankuesja ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 2808/2023 për tërheqjen e ankesës së parashtruar më datë 20.02.2023.

Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës me numër protokollit 2808/2023, e në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës më numër A.nr.375/2023 të datës 20.02.2023.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.




**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit është i paligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda me numër A.nr.375/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

